



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 611/7 prot.

Tiranë, më 26.10.2021

VENDIM
Nr.131, datë 26.10.2021

PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË ZBATIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 89, DATË 30.06.2021, NË INSTITUCIONIN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 89, dt. 30.06.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit Drejtoria e Përgjithshme Detare, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të intensifikojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë për institucionet që kanë nëpunës të cilët kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe Drejtoria e Përgjithshme Detare, institucion varësie i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 1025 prot., datë 30.04.2021, Drejtoria e Përgjithshme Detare ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare, vendimin paralajmërues me Nr. 89, dt. 30.06.2021, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Drejtoria e Përgjithshme Detare, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. 1025/2 prot., datë 01.07.2021, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrrur Drejtoria e Përgjithshme Detare, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësin: *Viron Kolaj* në pozicionin e punës *“Inspektor në Kapiterinë e Portit Durrës”*, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare.
2. Pozicioni respektiv i punës është shpallur pozicion i lirë, për t’u plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 89, dt. 03.06.2021, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Drejtoria e Përgjithshme Detare, për marrjen e*

masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme Detare.
3. Të njoftohet për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha